



PËR: INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT (IAP)

NGA: ODA E FIZIOTERAPEUTËVE TË KOSOVËS (OFTK)

LËNDA: KËRKESË PËR INICIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË KUSHTETUTSHMËRISË SË NENIT 30 DHE SHTOJCËS 9 TË LIGJIT NR. 08/L-196 PËR PAGAT NË SEKTORIN PUBLIK

DATE: 02 SHKURT 2023

➤ **Parashtrues i Kërkesës:**

1. Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (në tekstin në vijim, referuar me shkurtesën "OFTK"), - organizatë e pavarur që mbron dhe promovon interesat e anëtarëve të saj, (në tekstin në vijim: parashtruesi i kërkesës), në cilësinë e palës.
2. Parashtruesin e kërkesës, në bazë të autorizimit¹ e përfaqëson në Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin në vijim: IAP), i autorizuari i tij.

➤ **Baza Ligjore:**

3. Kërkesa parashtrohet mbi bazën e nenit 16 dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit;

➤ **Lëndë e Kërkesës:**

4. Kërkesa parashtrohet në lidhje me Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik², miratimi dhe hyrja në fuqi e të cilit, si i tillë, përbën shkelje të të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje si dhe instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Kërkesa parashtrohet për shkak të:

- Shkeljes së parimit të sundimit të ligjit nga neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës;
- Shkeljes së parimit të barazisë para ligjit dhe ndalimit të diskriminimit nga neni 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të lidhur me parimin e shtetit të së drejtës;

¹ Bashkëngjitur në këtë kërkesë: Autorizimi për Avokatin Faton Fetahu;

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=68695>

Me propozim:

5. Që pas hetimit të pretendimeve të parashtruara në këtë kërkesë, IAP mbi bazën e paragrafit 10 të nenit 16 të Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, të iniciojë në Gjykatën Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 30 (par. 1 dhe 2) dhe shtojcës 9 Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

➤ **Përmbledhja e fakteve:**

6. Më 12 shkurt 2019, Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte miratuar Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Ky ligj kishte hyrë në fuqi më 1 dhjetor 2019. Pas shqyrtimit të ankesave të shumta përkitazi me këtë Ligj, IAP e kishte proceduar të njëjtin në Gjykatë Kushtetuese, për vlerësim të kushtetutshmërisë së tij.
7. Mbi bazën e kësaj, më 9 korrik 2020, Gjykata Kushtetuese kishte miratuar kërkesën e IAP, me ç'rast kishte shfuqizuar në tërësi Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Rrjedhimisht, në vitin 2022 Qeveria e Republikës së Kosovës ka propozuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës Projektligjin nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me synimin, pos tjerash edhe të adresimit të gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese.
8. I njëjti, nga Kuvendi, ishte trajtuar në procedurë të përshpejtuar. Ndërkaq, pas miratimit të tij në lexim të dytë, më datë 5 janar 2023 ishte publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Në bazë të nenit 46 (Hyrja në fuqi), ky ligj hyn në fuqi një (1) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, përkatësisht më datë 05 shkurt 2023;
9. Më 26 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës (me vetëiniciativë) edhe në fazën e hartimit të projektligjit në Qeveri, kishte parashtruar komentet e tij te Grupi Punues i ministrisë përkatëse, me qëllimin që ky i fundit të marrë në konsideratë çështjet e rëndësishme që preknin në thelb statusin e fizioterapeutëve, kategorizimin e tyre dhe nivelin e koeficientëve të propozuar. Fatkeqësisht, këto komente nuk ishin marrë parasysh.

➤ **Shkeljet e pretenduara – procedurale dhe materiale:**

Shkeljet procedurale -

10. Ligji i kontestuar, në pikëpamje procedurale nuk i ka përmbushur kërkesat e shqyrtimit parlamentar në komisionet e përhershme parlamentare të Kuvendit sepse duke u trajtuar në procedurë të përshpejtuar – shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 34 par. 4, nenin 52, par. 1 dhe nenin 76, par. 3 dhe 8 të Rregullores së Kuvendit, është miratuar pa u shqyrtuar fare në Komisionin e Përhershëm për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Në këtë mënyrë, Kuvendi, me miratimin e ligjit kontestues, ka shkelur edhe vendimin nr. 08-V-449, të datës

15 dhjetor 2022, sipas të cilit, përveç përgjegjësive të përcaktuara për Komisionin funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal, në pikën 1.3 të këtij vendimi, ka paraparë shprehimisht që komisionet e përhershme të shqyrtojnë projektligjin deri më datë 21 dhjetor, ora 12:00³.

11. Rrjedhimisht, në bazë të Raportit për projektligjin të Komisionin funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (nr. prot. 08/3252/L-197, dt. 21.12.2022)⁴, konstatohet se nga katër (4) komisionet e përhershme të Kuvendit, ligji i kontestuar **është shqyrtuar** vetëm në dy prej tyre, respektivisht në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, si dhe në Komisionin për Integritet Evropian, ndërsa **nuk është shqyrtuar** në dy komisionet e tjera të përhershme të Kuvendit, respektivisht në Komisionin për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.

12. Si më sipër, duke mos e përfillur procedurën e paraparë me Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Vendimin e Kuvendit, nr. 08-V-449, datë 15 dhjetor 2022, Kuvendi ka bërë shkelje të procedurës në miratimin e ligjit kontestues. Në këtë mënyrë, është cenuar neni 77 (Komisionet) i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në par. 1 të të cilit janë paraparë llojet e komisioneve parlamentare, ku përveç tjerash, shprehimisht janë paraparë edhe komisionet e përhershme të Kuvendit. Neni 77 i Kushtetutës përcakton:

Neni 77 [Komisionet]

1. Kuvendi i Kosovës **emëron komisione të përhershme**, komisione funksionale dhe komisione ad hoc, që pasqyrojnë përbërjen politike të Kuvendit.

2. Kuvendi, me kërkesën e një të tretës (1/3) së të gjithë deputetëve të tij, cakton komisione për një çështje të veçantë, duke përfshirë edhe çështje hetimore.

3. Së paku një zëvendëskryesues i secilit komision parlamentar, do të jetë nga radhët e komunitetit tjetër nga ai i kryesuesit.

4. Pushtetet dhe procedurat e komisioneve përkufizohen me Rregulloren e Punës të Kuvendit.

13. Mbi bazën e nenit 77 të cekur më sipër, janë paraparë edhe kompetencat e komisionit në nenin 29 (Kompetencat e komisionit) të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe nenin 42 (Komisionet e përhershme dhe komisionet funksionale) të saj, ku në par. 3 të këtij neni, shprehimisht janë paraparë katër (4) komisionet e përhershme të Kuvendit, ndërsa në par. 5 është paraparë përgjegjësia e këtyre komisioneve për shqyrtimin e të gjitha projektligjeve dhe akteve të tjera që miratohen në Kuvend. Këto nene shprehimisht

³ Bashkëngjitur Vendimi i Kuvendit, nr. 08-V-449, datë 15 dhjetor 2022;

⁴ Raporti për projektligjin të Komisionin funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (nr. prot. 08/3252/L-197, dt. 21.12.2022);

përcaktojnë:

“KREU VIII KOMISIONET E KUVENDIT

Neni 29 Kompetencat e komisionit

- 1. Komisioni i Kuvendit, sipas fushëveprimit të tij, shqyrton projektligjet, aktet dhe dokumentet e tjera që parashtrohen për shqyrtim në Kuvend.**

Neni 42 Komisionet e përhershme dhe komisionet funksionale

1. Kuvendi formon komisione të përhershme dhe komisione funksionale.
 2. Kuvendi, miraton formimin e komisioneve, si në paragrafin 1 të këtij neni, dhe ua përcakton fushëveprimin e tyre.
 - 3. Komisionet e përhershme janë komisionet që mbulojnë fushat përkatëse si: buxhet dhe financa, legjislacion, integrim evropian dhe të drejtat dhe interesat e komuniteteve.**
 - 4. Komisioni i përhershëm i shqyrton të gjitha projektligjet dhe aktet e tjera, nga fushëveprimi i tij, e që parashtrohen në Kuvend dhe ngarkohet me vendim të Kuvendit.**
 5. Komisioni funksional i shqyrton projektligjet dhe aktet e tjera vetëm nga fushëveprimi tij.”
14. Po ashtu, ligji i kontestuar, në pikëpamje procedurale, bie ndesh edhe me nenit 76 (Shqyrtimi i projektligjit në komisione), të Rregullores, në të cilin shprehimisht është paraparë detyrimi që Komisionet e përhershme të shqyrtojnë projektligjin me amendamentet eventuale të propozuara. Ky nen, në paragrafin 8 shprehimisht përcakton:

“Neni 76 Shqyrtimi i projektligjit në komisione

8. Komisioni i përhershëm, shqyrton projektligjin me amendamentet e propozuara nga komisioni përgjegjës-raportues, si dhe amendamentet e propozuara nga të autorizuarit sipas paragrafit 3 të këtij neni. Komisioni i përhershëm, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga data e marrjes së raportit, duhet të paraqesë raportin për projektligjin dhe për amendamentet e Komisionit përgjegjës-raportues, pas këtij afati raporti i Komisionit përgjegjës-raportues procedohet për miratim në seancë plenare.”

15. Përfundimisht, konsiderojmë se ligji i kontestuar, është miratuar në procedurë parlamentare që ka rezultuar me shkelje esenciale të dispozitave të Rregullores së Punës së Kuvendit – duke cenuar kompetencat dhe përgjegjësitë e dy komisioneve të përhershme parlamentare, si dhe ka cenuar edhe Nenin 77 [Komisionet] dhe Nenin 78 [Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

➤ **Shkeljet materiale-**

16. Shkelja e nenit 7 (Vlerat) dhe nenit 24 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës së Kosovës;

17. Ligji i kontestuar përmban një nen jo kushtetues (30, par 1 dhe 2) si dhe në shtojcën nr. 9 të tij – Nëpunësi Publik i Sistemit Shëndetësor), Fizioterapeutëve si nëpunës publik shëndetësor të përcaktuar me numrin 17, 18 dhe 19 të shtojcës, ua cënon ecencialisht të drejtat e tyre nga marrëdhënëia e punës duke i kategorizuar në nivel të pagës e cila i vë në pozitë diskriminuese me kategoritë e tjera të nëpunësve publik shëndetësor.

18. Respektivisht, shkeljet e lartëcekura të ligjit, bien ndesh edhe me nenet 7 dhe 24 të Kushtetutës, si në vijim:

Kundërkushtetutshmëria e nenit 30 të ligjit:

19. Neni 30 (Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor), i Ligjit Nr. 08/I-196 për Pagat në Sektorin Publik, në mënyrë eksplicite vendos kufizim vetëm për nëpunësit e sistemit shëndetësor për përfitimin e shtesës mbi pagën bazë. Në bazë të këtij neni, vetëm nëpunësit e sistemit shëndetësor që punojnë në sektorin publik, kanë të drejtë në këtë shtesë, por jo edhe nëpunësit shëndetësor publik që mund të punojnë edhe në sektor privat (në punë sekondare). Ky nen, në paragrafin 1 dhe 2 të tij, shprehimisht përcakton:

1. *Shtesa për nëpunësen/in e sistemit shëndetësor përfitohet nga nëpunëset/lit të cilët vendosin të kenë një karrierë profesionale shëndetësore të përqendruar vetëm në sektorin publik.*
2. *Shtesa e përcaktuar në paragrafin 1. përfitohet për aq kohë sa nëpunësja/i i sistemit shëndetësor ushtron profesionin e saj/tij, vetëm në institucion shëndetësor publik.*

20. Rrjedhimisht, një kufizim i tillë duke u vendosur vetëm për sektorin e shëndetësisë, por jo edhe për sektorët e tjerë të zyrtarëve publik, paraqet shkelje të qartë të parimit kushtetues të barazisë para ligjit, dhe mosdiskriminimit, i përcaktuar në nenin 3 (2) dhe 24 të Kushtetutës, në të cilët përcaktohet shprehimisht:

“Neni 3 [Barazia para Ligjit]

2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.”

“Neni 24 [Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.

2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.

21. Ky përcaktim ligjor i shprehur si një kufizim i qartë në ushtrimin e ligjshëm të marrëdhënies së punës, respektivisht përfitimit të ligjshëm të shtesës në pagë si një e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës, për nëpunësit e sistemit shëndetësor, do të këtë për pasojë të shumta dhe për më tepër, si i tillë, nuk është në pajtueshmëri me Aktgjykimin në rastin Nr. K0131/12⁵ (Parashtrues Dr. Shaip Muja dhe 11 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës), në bazë të të cilit, kufizime të tilla, si “mos lejimi i nëpunësve të sistemit shëndetësor që të punojnë edhe në sektorin privat” apo “heqja e të drejtës së shtesës në pagë, vetëm për nëpunësit që punojnë edhe në sektorin privat shëndetësor”, është jokushtetuese. Për më tepër shih, aktykimin e cekur më sipër:

Kundërkushtetueshmëria e Shtojcës Nr. 9 - Nëpunësi Publik i Sistemit Shëndetësor të ligjit:

22. Ligji i kontestuar, në Shtojcën Nr. 9 - Nëpunësi Publik i Sistemit Shëndetësor të ligjit, është në kundërshtim të plotë në radhë të parë me nenin 4 të ligjit - Parimet e sistemit të pagave, por edhe në mënyrë substanciale shkel të drejtat dhe liritë kushtetuese, përfshirë parimet dhe vlerat e përcaktuara në nenin 7 të Kushtetutës.

23. Derisa, në nenin 4 të ligjit, janë paraparë parimet e sistemit të pagave, në paragrafin 1.4 të këtij neni, është përcaktuar se njëri ndër parimet në të cilat është mbështetur përcaktimi i pagave, respektivisht grupimi, kategorizimi dhe niveli i koeficientit të pagave, është edhe parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit. Në bazë të këtij parimi, të përcaktuar në paragrafin 4.1 të nenit 4 të ligjit, përcaktohet shprehimisht:

“1.4. parimi i barazisë dhe mos-diskriminimit – nënkupton që secili, pa kurrëfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë pagë të barabartë, duke marrë parasysh natyrën e punës, kërkesat për vendin e punës, institucionin ku ushtrohet detyra si dhe kualifikimin.”

24. Si më sipër, Shtojca Nr. 9 - Nëpunësi Publik i Sistemit Shëndetësor të ligjit, është në kundërshtim të plotë me parimin e cekur më sipër sepse në rastin e profesionistëve që ushtrojnë profesionin e fizioterapeutit, renditja e tyre në këtë shtojcë, me numrin 17, 18 dhe 19 apo të kategorizuar në klasën H15, H16 dhe H17, përbën trajtim diskriminues në raport me nëpunësit e tjerë të sektorit të shëndetësisë, që kanë detyra dhe kualifikime të njëjta.

⁵ Për më tepër shih: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/KO131_12_Aktgjykim_SHQ_.pdf

25. Trajtimi i pabarabartë në Shtojcën 9, i fizioterapeutëve është i shprehur në dy forma: e para, trajtim të pabarabartë brendapërbrenda këtyre profesionistëve në kuptim të mos trajtimit në bazë të kualifikimit të fituar – gradës shkencore (Bachelor, Mastër dhe PhD). Si dhe, e dyta, trajtim të pabarabartë të tyre në raport me profesionistët tjerë shëndetësor (p.sh psikolog klinik), të cilat kanë arsimim dhe kualifikime të nivelit të njëjtë me fizioterapeutët.
26. Në bazë të të dhënave të OFTK, numri i fizioterapeutëve që punojnë në sektorin publik shëndetësor, është 110 (Niveli Primar – 3, Niveli Sekondar – 37, Niveli Terciar – 73) dhe prej tyre, 52 profesionistë kanë mbaruar studimet master dhe ligji nuk ua njeh fare arsimimin e tyre.
27. Trajtimi i pabarabartë brendapërbrenda fizioterapeutëve si grup profesionistësh - në kuptim të mos trajtimit në bazë të kualifikimit të fituar – gradës shkencore (Bachelor, Mastër dhe PhD), paraqet edhe trajtim të pabarabartë të tyre edhe në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, aq më tepër se Shtojca kontestuese nr. 9 fare nuk i ka kategorizuar fizioterapeutët specialist dhe fizioterapeutët në specializim, duke u kufizuar vetëm në kategorizimin e fizioterapeutëve në tri nivelit e organizimit të shërbimeve shëndetësore dhe aq me keq, duke ua njohur vetëm gradën shkencore “bachelor” - niveli 6 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, por jo edhe gradat më të larta shkencore, respektivisht nivelin 7 dhe 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.
28. Rrjedhimisht, ligji i kontestuar në shtojcën Nr. 9 të tij, fare nuk e njeh arsimimin e lartë të nivelit 7 dhe 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, për këto kategori profesionistësh: Infermier, Fizioterapeut, Logoped, Teknik i Radiologise diagnostike, Teknik i Radioterapisë, Miekësi sanitare, Laborant, Mami, Teknik. Ndërkaq, të njëjtit edhe pse kanë arsim të lartë universitar, rangohen njëjtë me profesionistët shëndetësor me shkollim të mesëm, respektivisht dallimi në koeficient është 0.30.
29. Këta profesionist shëndetësor janë ndarë në tri klasa: H15 Niveli tretësor i shëndetësisë –Bachelor; H16 Niveli sekondar i shëndetësisë –Bachelor; H17 Niveli parësor i shëndetësisë –Bachelor.
30. Ligji i kontestuar, duke mos e njohur fare arsimimin e lartë të nivelit 7 dhe 8 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, për kategoritë e profesionistëve si Infermier, Fizioterapeut, Logoped, Teknik i Radiologise diagnostike, Teknik i Radioterapisë, Miekësi sanitare, Laborant, Mami, Teknik, bie në kundërshtim të plotë edhe me nenin 22 (Procesi edukativ –arsimor), të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në bazë të të cilit, të gjithë profesionistët shëndetësorë me kualifikim specialistik që kanë më shumë se tri (3) vite të përvojës së punës specialistike në institucionet ku zhvillohet procesi edukativ–arsimor (.....) janë

mentor klinik dhe marrin kompensim financiar për punën e tyre në bazë të aktit nënligjor nga paragrafi I i këtij neni si dhe aktit nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.

31. Nga ana tjetër, në bazë të nenit 3 (Përkufizime), të ligjit, përkufizimi i pagës bazë, është përcaktuar në paragrafin 1.9 dhe shprehimisht përcakton se: “*paga bazë – nënkupton elementin kryesor fiks të kundërvlerës monetare mujore që i përgjigjet nivelit të kompleksitetit të funksionit, pozitës apo gradës dhe nivelit të kualifikimit të kërkuar për atë funksion, pozitë apo gradë, në përputhje me shtojcat e këtij ligji*”. Ndërsa nga ana tjetër, fizioterapeutëve ligji i kontestuar, përveç nivelit bachelor, të njëjtëve nuk ua njeh kualifikimet e tjera, përkundër se në bazë të këtij përkufizimi, do të duhej tju njihej sikurse grada ashtu edhe kualifikimi për pozitën e tyre profesionale që e ushtrojnë.
32. Shtojca e kontestuar nr. 9, nuk parasheh as rregullimin dhe trajtimin e pozitave menaxheriale të fizioterapeutëve, si p.sh. Kryefizioterapeut – i cili aktualisht në sitemin shëndetësor e ka koeficientin 7.2 ndërsa me këtë shtojcë nuk i është caktuar kategoria e as koeficienti.
33. Ligji i kontestuar, gjithashtu është diskriminues në raport me fizioterapeutët, për arsye se trajtimin e tyre e bën në bazë të niveleve të organizimit të kujdesit shëndetësor (parësor, dytësor dhe tretësor), siç përcaktohet me paragrafin I të nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi (Nivelet e kujdesit shëndetësor) por jo edhe për profesionistët e tjerë shëndetësor si:
- *Mjek specialist, Mjek specialist i Mjekësisë Familjare, Stomatolog Specialist, Farmacist specialist, Farmacist Klinik, Psikolog Klinik Specialist;*
 - *Mjek në Specializim, Ekspert i Fizikës Mjekësore, Psikolog Klinik në Specializim;*
 - *Mjek i përgjithshëm, Stomatolog, Farmacist, Mjek Veterinar / Fizikan Mjekësor në Specializim/Inspektorë shëndetësor dhe farmaceutik;*
 - *Psikolog Klinik;*
34. Pra, duke marrë për bazë nivelet e organizimit të kujdesit shëndetësor (parësor, dytësor dhe tretësor), ligji për Paga, nuk zbatimin e trajtimit të profesionistëve shëndetësor në bazë të niveleve ku shërbejnë, por këtë qasje e ndjekë vetëm për fizioterapeutët, Infermierët, Logopedët, Teknikët e Radiologjisë diagnostike, Teknikët e Radioterapisë, Mjekësisë sanitare, Laborantët, Mamitë dhe Teknikët, por jo edhe për profesionistët e tjerë shëndetësor të cekur si më sipër.
35. Në këtë mënyrë, Shtojca 9 e Ligjit të kontestuar institucionalizon trajtimin e pabarabartë të nëpunësve të sektorit të shëndetësisë, duke vendosur dallim në trajtim, ku për një pjesë të tyre, nuk zbatohet pranimi i organizimit të kujdesit shëndetësor në nivelet përkatëse në bazë të nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

36. Nga ana tjetër, ligji i kontestuar kategorizimin e fizioterapeutëve e bën në tri nivele të organizimit të kujdesit shëndetësor, mirëpo, në bazë të nenit 34 (Mjekësia fizikale dhe rehabilituese) të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, mjekësia fizikale dhe rehabilituese ofrohet vetëm në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor dhe jo në nivelin parësor. Në këtë mënyrë, kolizioni mes këtyre dy ligjeve, ka për pasojë trajtimin e pabarabartë dhe diskriminimin e fizioterapeutëve.
37. Po ashtu, me ligjin e kontestuar, konsiderojmë se rritet pabarazia në koeficient në mes të profesionistëve shëndetësorë dhe shkollim të tyre të lartë. Kjo dëshmohet lehtësisht duke karahasuar disa prej koeficienteve aktual në sistem të pagesave me ligjin e kontestuar:
- Mjek specialist - aktualisht e ka koeficientin 8.4, me ligjin e kontestuar është 12.0,
 - Mjek ne specializim - aktualisht e ka koeficientin 8.0, edhe me ligjin e kontestuar është 8.0,
 - Farmacist Msc - aktualisht e ka koeficientin 8.4, me ligjin e kontestuar është 12.0,
 - Psikolog Klinik Bachelor - aktualisht e ka koeficientin 7.2 me ligjin e kontestuar është 7.0,
 - Logoped - aktualisht e ka koeficientin 7.2, me ligjin e kontestuar i ulet në 5.6,
 - Fizioterapeut Bachelor - aktualisht e ka koeficientin 7.2 me ligjin e kontestuar ulet në 5.6,
 - Infermierile Bachelor - aktualisht e ka koeficientin 5.4, me ligjin e kontestuar i është 5.6, 5.5 dhe 5.4,
 - Kryeinfermiere - aktualisht e ka koeficientin 7.2, me ligjin e kontestuar është ulë në 6.2,
 - Kryefizioterapeut - aktualisht e ka koeficientin 7.2 me ligjin e kontestuar nuk i është caktuar koeficienti.
38. Ligji i kontestuar nuk i respekton kriteret e OBSH-së për profesionistët shëndetësor, dhe nuk njehë shkollimin e tyre - pergaditjen profesionale. Ndërkaq, nga ana tjetër, në bazë të kësaj shtojce, profesionistët shëndetësor janë kategorizuar si vijon: Mjek i pergjithshëm, Stomatolog, Farmacist, Mjek Veterniar/Fizikan Mjekësor në Specializim /Inspektore shëndetësor dhe farmaceutik - janë në një klasë - H10 pa fushë të zbatimit.
39. Gjithashtu, profesionistët shëndetësor: Mjek specialist, Mjek specialist i Mjekesisë Familjare, Stomatolog Specialist, Farmacist specialist, Farmacist Klinik - janë në një klasë: H10 pa fushë të zbatimit.
40. Edhe psikologet klinik trajtohen në një klasë H11 pa fushë të zbatimit, ani pse kanë edukim të barabartë me 180ECTS +120 ECTS si Infermierët, Fizioterapeutët, Logopedët, Teknikët e Radiologisë diagnostike, Teknik i Radioterapisë, Mjekësi sanitare, Laborant, Mami.
41. Diskriminimi në bazë të shtojcës 9 të ligjit, shprehet edhe në trajtimin në mes të profesionistëve shëndetësor, si bie fjala, mundëson që psikologëve klinik, farmacistëve,

fizikantëve mjekësor të ju njihet edukimi i lartë dhe specializimi, por jo edhe profesionistëve tjerë shëndetësor si: fizioterapeut, infermier, mami, logoped, teknik i radiologjisë, laborant biokimist të mos njihet edukimi bazik i lartë universitar.

42. Në bazë të nenit 69 Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në kuadër të profileve të profesionistëve shëndetësorë, hyn edhe Fizioterapeutët (1.5 Fizioterapeut i diplomuar), dhe të njëjtëve në bazë të këtij ligji ju njihet shkollimi specialistik (shih nenin 72, 73 dhe 74), ndërsa ky shkollim nuk ju njihet fare në ligjin e kontestuar.
43. Për sa më sipër, kërkojmë nga IAP që shkeljet e mësipërme ti adresoj përmes kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë së këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që kjo e fundit të konstatoj se ky ligj (i) nuk mundëson pagë të barabartë për punë të barabartë për të gjithë të punësuarit në sektorin public sipas përgjegjësisë institucionale dhe ndërlukeshmërisë në punë; (ii) nuk reflekton parimet e përcaktuara të vet Ligjit të kontestuar në nenin 30 dhe Shtojcën 9 të tij.

Cenimi i nenit 7 [Vlerat] i Kushtetutës nga Ligji i kontestuar:

44. Kushtetuta, në nenin 7 [Vlerat], e përcakton sundimin e ligjit si një ndër vlerat e rendit kushtetues në vend. Ndërkaq, sundimi i ligjit si parim kushtetues dhe ligjor në kuptim të Listës Kontrolluese për Sundimin e Ligjit të Komisionit të Venecias, përveç tjerash ngërthen në vete (i) respektimin e të drejtave të njeriut dhe (ii) ndalimin e diskriminimit dhe (iii) barazinë para ligjit – të cilat, përveç që paraqesin të drejta themelore të njeriut, ato gjithashtu paraqesin edhe koncepte të sundimit të ligjit.
45. Në këtë kuptim, ligji i kontestuar nuk ka arritur të sigurojë “pagë të barabartë për punë të barabartë”, në të gjithë sektorin public. Po ashtu, Ligji i kontestuar ka krijuar një situatë divergjente për pozita të barasvlershme në radhët e profesionsitëve shëndetësor në shtojcën nr. 9, sepse në nivelet e ndryshme pozitat e njëjta apo të krahasueshme janë vlerësuar me nivele të ndryshme të pagave, pa marrë për bazë arsimin dhe kualifikimet profesionale.
46. Rrjedhimisht, ligji i kontestuar nuk është në pajtim me nenin 23 paragrafi (2) të DUDNJ-së, në të cilin përcaktohet që: *“Secili, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të barabartë të marrë rrogë të barabartë.”* Veçanërisht kur merret për bazë fakti që se paragrafi (1) i nenit 22 të Kushtetutës, përcakton që DUDNJ zbatohet drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me këtë Deklaratë, kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave të ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike.

47. Në rrethanat e rastit konkret, trajtimi diskriminues i fizioterapeutëve më ligjin e pagave, bie ndesh edhe me Aktgjykimin në rastin nr. KO219/19⁶ (parashtrues Avokati i Popullit Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-III për Pagat në Sektorin Publik), në bazë të të cilit, duke pasur parasysh që të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe si të tilla janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësojë ose të cenojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe të lirive themelore të përcaktuara nga Kushtetuta dhe nga ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, paraqesin diskriminim.

48. Ligji i kontestuar, po ashtu nuk ka adresuar gjetjet e Aktgjykimit në rastin nr. KO219/19, për sa i përket zbatimit të duhur të përkufizimit të qartë të parimit të “pagës së njëjtë për punë të njëjtë” dhe “punës me vlerë të barabartë”. Sipas këtij aktgjykimi (pika 266), përcaktohet se: “Për të vlerësuar nëse një nëpunës i caktuar i një institucioni të caktuar publik po kryen punë me vlerë të barabartë, duhet të merren parasysh një sërë faktorësh përfshirë natyrën e punës, institucionin në të cilin ushtrohet detyra, edukimi dhe trajnimi përkatës që kërkohet, si dhe kushtet e tjera të punës. Rrjedhimisht, në përcaktimin dhe zbatimin e parimit “pagë e njëjtë për punë të njëjtë” dhe “punë me vlerë të njëjtë” në kontekstin vendor, ligjvënësi duhet të merr parasysh tiparet e sistemit kushtetues të Republikës së Kosovës..”

49. Si më sipër, konsiderojmë se përmes këtij ligji, profesionistët shëndetësor në përgjithësi – janë subjekt i trajtimit të pabarabartë sipas nenit 30 të ligjit, ndërsa fizioterapeutët po ashtu janë subjekt i diskriminimit edhe në raport me shtojcën nr. 9 të ligjit, që për rrjedhojë, konsiderojmë se përmes tij, janë shkelur shkelur neni 7 dhe 24 i Kushtetutës dhe nenet përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare të cilat zbatohen drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës, e të cilat shprehimisht përcaktojnë:

Neni 7 [Vlerat] i Kushtetutës:

I. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

Neni 22 (Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) i Kushtetutës:

“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, garantojnë me Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet,

⁶ Për më tepër shih Aktgjykimin: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29924>

në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike”.

Neni 2 dhe 7 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948):

Neni 2

“ Secilit i përkasin të gjitha të drejtat dhe liritë e shpallura në këtë Deklaratë pa kurrfarë dallimesh në pikëpamje të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, mendimit politik ose çdo mendimi tjetër, të prejardhjes kombëtare a shoqërore, të pasurisë, të lindjes apo të ndonjë gjendje tjetër juridike. Përveç kësaj, nuk do të bëhen kurrfarë dallimesh në bazë të statusit politik, juridik apo ndërkombëtar të vendit ose territorit të cilit i përket ndonjë individ, qoftë kur ky vend ose territor është i pavarur, apo kur ndodhet nën kujdestari ose është jovehtëqeverisë a nën çfarëdo kufizimi tjetër të sovranitetit.”

Neni 7

“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë që, pa kurrfarë diskriminimi, të mbrohen njësoj nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për mbrojtje të barabartë kundër çdo diskriminimi që do të shkelte këtë Deklaratë, dhe kundër çdo nxitjeje për një diskriminim të tillë.”

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj:

Neni 14

“Ndalimi i diskriminimit Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

Protokolli nr. 12 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore:

Neni 1 Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

“1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1”.

50. Bazuar nga të gjitha të lartcekurat, duke marr për bazë specifikat e veçanta të kësaj çështjeje lëndore, kërkojmë nga IAP që pas shqyrtimit dhe administrimit të të gjitha provave dhe fakteve të parashtrua ne këtë kërkesë, mbi bazën e paragrafit 10 të nenit 16 të Ligjit Nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit, të iniciojë në Gjykatën Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 30 (par 1 dhe 2) dhe shtojcës 9 Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

➤ **Provat e bashkëngjitura:**

- Autorizimi i Avokatit;
- Lista e kompetencave themelore të Fizioterapisë (Niveli 6) sipas ER-ËCPT-së;
- Lista e përshkrimeve të detyrave dhe përgjegjësisë të punës të Fizioterapeutit Bachelor (të diplomuar);
- Licencat e punës;
- Parashtrësia nga z. Esther – Mary D’Arcy, Kryetar, Rajoni i Evropës, Organizata Botërore e Fizioterapisë;
- Vendimi nr. Ref. 1568/20 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditimin e programeve, përfshirë edhe programin e Fizioterapisë në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, datë 11.09.2020;
- Vendimi nr. Ref. 3011/21 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditimin e programeve, përfshirë edhe programin e Fizioterapisë në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, datë 12.08.2021;
- Vendimi nr. Ref. 3010/21 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditimin e programeve, përfshirë edhe programin e Psikologjisë në kuadër të Fakultetit Filozofik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, datë 12.08.2021;
- Dëshmia e Pagës (bruto dhe neto);
- Parashtrësia e Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës për grupin punues, dt. 26 gusht 2022;
- Programi i studimeve të Fizioterapisë BA dhe MA (e hijezuar me ngjyrë të verdhë);
- Kontata e punës së Fizioterapeutit;
- Bashkëngjitur Vendimi i Kuvendit, nr. 08-V-449, datë 15 dhjetor 2022;
- Raporti për projektligjin të Komisionin funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal (nr. prot. 08/3252/L-197, dt. 21.12.2022);

Për dhe në emër të Kryetarit të Odës së Fizioterapeutëve të Kosovës Ass. MSc. **Feim Gashi:**

Av. Faton Fetahu



**AVOKAT-LAWYER
FATON FETAHU**
Tel. 044/981-529
E-mail: fetahufaton@gmail.com
Nënë Tereza Nr. 20, 10000 Prishtinë